



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 12.02.2021

Nr: 04

VENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.4, DATË 13.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR LLOJIN DHE KARAKTERISTIKAT TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJNË SISTEMET DHE PAJISJET E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK QË PROKUROHEN DHE PËRDOREN NË ZGJEDHJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 12.02.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO	Kryetar
Arens	ÇELA	Anëtar
Dritan	ÇAKA	Anëtar
Helga	VUKAJ	Anëtar
Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë".

BAZA LIGJORE: Neni 20, pika 1, shkronja "e", pika 2, shkronja "c", neni 179, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



Data: 12.02.2021

Nr. 4

Për disa ndryshime në Vendimin nr.4, datë 13.11.2020 "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë"

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "e", pika 2, shkronja "c" dhe , nenit 179, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Referuar nenit 12, pika 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Referuar nenit 20, pika 1, shkronja "e", e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë.

Referuar nenit 20, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, "Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi".

Referuar nenit 179, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, "Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që do të përdoren në zgjedhje do të implementohen me projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më shumë se 20 për qind të zgjedhësve, duke filluar nga zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat sipërcituar, administrata e KQZ ka përgatitur projekt aktin për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020 "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë".

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Komisioni Rregullator, mbështetur në nenin 20, pika 1, shkronja "e", pika 2, shkronja "c" dhe nenit 179, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,



Data: 12.02.2021
Nr. 4

Për disa ndryshime në Vendimin nr.4, datë 13.11.2020 "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë"

VENDOSI

1. Në vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 do të zbatohet projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave. Projekti pilot do të kryhet me anë të sistemit dhe/ose pajisjeve elektronike, në një nga Zonat e Administrimit Zgjedhor në bashkinë e Tiranës sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Zona e Administrimit Zgjedhor duhet të ketë në juridiksion territorial të saj, jo më shumë se 55 Qendra Votimi. Përcaktimi i Zonës së Administrimit Zgjedhor ku do të zbatohet projekti pilot bëhet me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve."
 - b) Gërma "o", e pikës 10 shfuqizohet.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana	NANO	Kryetar
Arens	ÇELA	Anëtar
Dritan	ÇAKA	Anëtar
Helga	VUKAJ	Anëtar
Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar

